



**Praktikat e një Menaxhimi të  
Qëndrueshëm të Pyjeve Komunale –  
Impaktet dhe mësimet e nxjera nga  
Shqipëria**

April 2014

**Connecting Natural Values & People Foundation**

Project implementation:



Financed by:



**Swedish Development Cooperation**

## Përmbajtja

<b>Abbreviations .....</b>	<b>2</b>
<b>Praktikat për një Menaxhim të Qëndrueshëm të Pyjeve Komunale – Ndikimet dhe mësimet e nxjera nga Shqipëria .....</b>	<b>3</b>
<b>Zbërthimi i Planit Vjetor .....</b>	<b>6</b>
<b>Mbledhja e taksave dhe tarifave për ri-investime në PKK.....</b>	<b>9</b>
<b>Pylli i Fermerit.....</b>	<b>14</b>
<b>Sfidat dhe mundësitë .....</b>	<b>16</b>
<b>Konkluzione dhe Rekomandime .....</b>	<b>19</b>

## Abbreviations

CNVP	Fondacioni Bashkojme Vlerat e Natyres me Njerezit
DSHP	Drejtoria e Sherbimit Pyjor
MAP	Bimet Mjekesore dhe Aromatike
MMPAU	Ministry of Mjedist, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave
MM	Memorandum Mirkuptimi
NjQV	Njesi e Qeverisjes Vendore
NRDP	Natural Resources Development Project
NTFP	Non-Timber Forest Products
PKK	Pyje e Kullota Komunale
Sida	Organizata Nderkombetare Suedeze per Zhvillim
SNV	Organizata Holandeze per Zhvillim
SHPPKK	Shoqqata e Perdoruesve te Pyjeve e Kullotave Komunale

# Praktikat për një Menaxhim të Qëndrueshëm të Pyjeve Komunale – Ndikimet dhe mësimet e nxjera nga Shqipëria

## 1. Parathënie

Transferimi i pronësise mbi pyjet e kullotat komunale ne Shqipëri drejt komunave e bashkive ndryshoi rregullat dhe fokusin e menaxhimit te tyre. Masat e reja të percaktuara ne legjislacionin e pyjeve ju dha me shume autoritet dhe përgjegjësi Njësite të Qeverisjes Vendore (NJQV). Kontrolli i mëparshëm I centralizuar i shtetit rezultoi në humbjen e përdorimit tradicional prej familjeve lokale të cilat e kanë patur tradicionalisht në pronësi tokën pyjore. Për më tepër, përgjegjësitë e paqarta dhe/ose të mbivendosura ndaj përdoruesve të pyjeve dhe kullotave çuan në konflikte dhe praktika të paqëndrueshme të menaxhimit të pyjeve nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor dhe Njesitë e Qeverisjes Lokale.

Nga viti 1999 jane themeluar Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave (SHPPK) te cilat jane krijuar për të përfaqësuar familjet rurale. Sipas statuteve, të gjithë anëtarët e një komuniteti që shfrytëzojnë Pyjet dhe Kullotat Komunale janë automatikisht anëtarë të shoqatës. SHPPK-të përmbushin një numër rolesh dhe funksionesh. SHPPK përfaqësojnë pronarët dhe përdoruesit e pyjeve në nivele lokale, koordinojnë dhe implemetojnë në bashkëpunim me perdoruesit dhe NjQV pyjet e kullotat komunale; bejne lidhjet me autoritet dhe sherbimin keshillimor shtetëror. Strukturat e Federatave ne nivele rajonale dhe kombëtar përfaqësojnë pronarët dhe përdoruesit e pyjeve të niveleve të ndryshme në zhvillimin e pyjeve, reformave në pyje, procesin e vendimarrjes si dhe zhvillojnë dialogun per politikat pyjore; ofrojnë ngritjen e kapaciteteve dhe shërbime ekonomike për përdoruesit e pyjeve e kullotave; llobojnë dhe mbrojnë interes e përdoruesve; mbështesin përdoruesit e pyjeve dhe kullotave në krijimin e rrjeteve dhe marrëdhënieve me të tjerët. Projekti "Forcimi I Pyjeve Komunal II" (2010-2014) i zbatuar nga (CNVP) me mbështetjen financiare të Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida) dhe SNV Organizata Hollandeze për Zhvillim, u përqëndrua në forcimin e kapaciteteve të NJQV-ve dhe SHPPK-ve. Nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të NjQV-ve dhe SHPPK-ve, projekti synoi të forcojë menaxhimin e Pyjeve dhe Kullotave Komunale (PKK) dhe monitorimin, për të rritur rehabilitimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të PKK me qëllim të përgjithshëm rritjen e produktivitetit të zonave pyjore dhe kullosore afër fshatrave dhe komuniteteve në mënyrë që të plotësojë kërkesat lokale për dru zjarri dhe gjeth për blektorinë dhe të gjenerojë të ardhura shtesë nëpërmjet zhvillimit të Produkte Pyjore jo Drusore.

Përderisa SHPPK-të përfaqësojnë përdoruesit e PKK-ve, është thelbësore që ato të luajnë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e pyjeve në bashkëpunim të ngushtë me Njësitë e Qeverisjes Vendore. Megjithatë, zbatimi i bashkëpunimit dhe aktiviteteve në menaxhimin e PKK është ende në një fazë të hershme. Ekziston nevoja për të përmirësuar më tej bashkëpunimin mes tyre dhe aktorëve të tjerë kryesorë. Në terma teknike, menaxhimi i pyjeve në çdo komunë është formuluar nga planet 10 vjeçare të menaxhimit të PKK-ve. Pjesa më e madhe e planeve janë përgatitur nga "Projekti Shqiptar për Pyjet " me mbështetjen e Bankës Botërore gjatë viteve 1998-2004 dhe jane rishikuar në periudhën 2008-2013 nga ana e "Programit të Zhvillimit të Burimeve Natyrore" të Bankës Botërore. Megjithatë, kapacitetet e NJQV-ve janë ende të kufizuara:





1) për zbërthimin e planeve të Menaxhimit të PKK-ve në plane vjetore për veprim (plani operacional), 2) për të mbështetur pyllin e familjes, 3) për të rritur të ardhurat nga pyjet dhe kullotat përmes mbledhjes së taksave dhe tarifave dhe 4) për të investuar përsëri në zonat e pyjeve dhe kullotave komunale.

Projekti i II për Forcimin e Pyjeve Komunale ka punuar mbi çështjet e përmendura më lart për të përmirësuar menaxhimin e PKK-ve. Ky dokument jep informacion mbi ndikimet dhe mësimet e nxjerra të projektit mbi praktikën e menaxhimit të PKK-ve. Ai jep gjithashtu të dhëna në konceptet, aktivitetet e projektit, rezultatet dhe ndikimet, sfidat dhe mundësitë. Ky studim funksion si një dokument bazë për mësimet dhe përdorim të mëtejshëm nëpërmjet rezultateve dhe përvojave. Përveç kësaj eksperience janë përgatitur edhe tre eksperiencat e tjera për të ndarë historitë përvojat tona të projektit të cilat i referohen impaktit të projektit në: 1) Sigurimin e të drejtës mbi pronësinë e pyjeve dhe kullotave komunale, 2) Grupet e prodhuesve dhe klubet e arrorëve dhe 3) Funksionimi i SHPPK-ve dhe Federatave.



Në këtë dokument, rezultatet e projektit që lidhen me menaxhimin e pyjeve janë përshkruar si mëposhtme: 1) bashkëpunimi në menaxhimin e pyjeve (kapitulli 2), plani vjetor i shfrytëzimit (kapitulli 3), mbledhja e taksave dhe tarifave për ri-investime në PKK (kapitulli 4) dhe Pylli i fermerit (kapitulli 5). Për më tepër, sfidat dhe mundësitë janë përshkruar në kapitullin 6, dhe ky dokument mbyllet me konkluzionet dhe rekomandimet në kapitullin 7.

## 2. Bashkëpunimi në menaxhimin e pyjeve

Për një menaxhim efektiv të pyjeve dhe kullotave komunale është e rëndësishme që aktorët kryesorë të bashkëpunojnë së bashku. Projekti II për Fuqizimin e Pyjeve Komunalë rrit bashkëpunimin mes aktorëve të mëposhtëm në rajonet e projektit si në Dibër, Gjirokastrë, Korçë, Kukës dhe Shkodër:

- **Komunat/NjQV**  
Komunat ose NjQV janë të zgjedhur në mënyrë demokratike dhe i shërbejnë komunitetit. Ato janë pronare të pyjeve dhe kullotave komunale.
- **Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave (SHPPK)**

SHPPKK janë ligjërisht të regjistruara si organizata me bazë komunitare, të formuara në nivel Komune dhe që përfaqësojnë interesat e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave brenda zonës së komunës.

- **Federatat Rajonale të SHPPK-ve**

Federatat Rajonale janë organizata umbrellë që përfaqësojnë interesat e SHPPK-ve të ndryshme në nivel komune brenda rajonit.

- **Drejtoria e Shërbimit Pyjor (DSHP)**

DSHP-të kanë një seksion të Shërbimit të Extensionit, i cili ka mandatin për të mbështetur e këshilluar NJQV-të me çështjet teknike për menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave. DSHP-të kanë gjithashtu edhe përgjegjësinë për menaxhimin e pyjeve komunale, sidomos në aktivitete e shfrytëzimit të pyllit.

- **Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Pyjeve**

Fakulteti i Pyjeve ka mbështetur projektin në zhvillimin e metodologjive për krijimin e fondeve të riinvestimit. Për më tepër, studentët u përfshinë në projekt dhe mbështetën matjet e sipërfaqeve provë të cilat japin informacion mbi pyllin e fermerit.



Është ndjekur një bashkëpunim shumë aktorësh për të siguruar bashkëpunim më të mirë në menaxhimin e pyjeve. Së pari, u sqaruan dhe u ra dakord për rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve kryesorë. Në veçanti u diskutuan rolet dhe përgjegjësitë e administratës së Komunave si pronarë të rinj të pyjeve dhe kullotave të transferuara, Rolet dhe përgjegjësitë e tyre përfshijnë: 1) kontrolli dhe rregulloret, 2) planifikimi vjetor 3) përgjegjësitë e menaxhimit dhe investimeve dhe 4) përfshirjen e komuniteteve dhe njohja e të drejtës të përdorimit tradicional të pyjeve dhe kullotave.



Projekti i II për Fuqizimin e Pyjeve Komunale shfrytëzoi marrëveshjet e partneritetit të krijuara nga Projekti i I për Fuqizimin e Pyjeve Komunale për të siguruar një qasje të koordinuar. Në secilën nga gjashtë rajonet pilot dhe në nivel kombëtar u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi (MM) me aktorët kryesorë të sektorit publik dhe të shoqërisë civile për të formalizuar këtë partneritet. MM ndihmoi për të qartësuar rolet dhe përgjegjësitë dhe për të nxitur marrëdhënie të ngushta midis aktorëve në sektorin e pyjeve. Ky partneritet gjithashtu rriti koordinimin efektiv dhe bashkëpunimin në shumë iniciativa të pjesëmarrësve, dhe ka krijuar mundësi për diskutime dhe negociata për çështjet që kanë të bëjnë menaxhimin e PKK të tilla si: 1) mbledhjes së taksave dhe tarifave, 2) ri-investim në zonat e PKK, 3) zbërthimi i planeve të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave komunale në një plan veprimi dhe 4) zhvillimi i pyllit të fermerit.

### Rezultatet

- Firmoset MM si nje udhëzues për bashkëpunim
- Qartësohen përgjegjësitë e NjQV-ve dhe palëve të tjera
- Marrëveshje mbi rolet dhe kompetencat e Komunës, DSHP dhe SHPPK në menaxhimin e PKK.
- Rritet bashkëpunimi midis aktorëve kyç (SHPPK, Federatave Rajonale, Komunave dhe DSHP-ve).
- Njohje më e mirë e SHPPK-ve nga Komunitat dhe DSHP-të.
- Ndarja e informacionit dhe rritja e bashkëpunimit midis specialistëve të grupit kyç.

Për më tepër, ky projekt ngriti grupet kyçe në çdo rajon për të rritur bashkëpunimin shumë palësh dhe për të mbështetur zbatimin e projektit në komunitet pilot. Këto grupe kyçe përbëheshin nga pylltarë profesionistë të DSHP-ve, si dhe përfaqësues të Federatave dhe SHPPK-ve.

### Zbërthimi i Planit Vjetor

Menaxhimi i pyjeve në çdo komunë jepet në planet 10 vjeçare të menaxhimit të PKK-ve. Edhe pse gjatë procesit të hartimit të planeve të menaxhimit të PKK duhej të kryeshin konsultime me komunitetet, në praktikë planet janë përgatitur pa pjesëmarrjen e tyre. Si rezultat, planet e menaxhimit nuk janë të lidhura me përdorimin tradicional të PKK-ve



dhe nuk përfshijnë aktivitete që janë të bazuara në pikëpamjet, idetë dhe nevojat e këtyre komuniteteve.

Prandaj, projekti i II për Forcimin e Pyjeve Komunale promovoi zbërthimin në mënyrë bashkëpunuese të Planeve 10 vjeçare të Menaxhimit të PKK në plane vjetore të veprimit (plane operacionale). Kjo mënyrë me pjesëmarrje është bazuar në dokumentin Nr. 4290 Datë 21.07.2011 të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) për përgatitjen e planeve operacionale vjetore në bazë të planit të menaxhimit të PKK.

Objektivat e përfshirjes së komunitetit në përgatitjen e planeve vjetore të zhfrytezimit ishin:

- Përmirësimi i planifikimit me pjesëmarrje në zbatimin e planeve të menaxhimit të pyjeve.
- Rritja dhe gjenerimi i të ardhurave
- Përmirësimi i strategjive të investimeve në pyje dhe kullota.



Projekti udhëhoqi procesin e përgjithshëm dhe përfshiu grupet kyçe rajonale. Fillimisht, grupet kyçe në Korçë dhe Kukës studiuuan, diskutuan dhe rishikuan formatin e planit operacional vjetore mbështetur në materialet ekzistuese të DSHP-ve. Drafti i rishikuar ju dërgua grupeve kyçe në rajonet e tjera të projektit për diskutime të mëtejshme dhe reagime. Në bazë të inputeve të tyre ato u finalizuan për përdorim të mëtejshëm.

Plani vjetor operacional ndihmon për të rritur në mënyrë të qëndrueshme administrimin dhe mbështetjen e duhur në përdorimin e pyjeve, kullotave dhe burimeve natyrore në pronësi të NJQV. Përgatitja dhe zbatimi i këtij plani vjetor operacional u përqendrua në praktikat tradicionale, rehabilitimin e pyjeve dhe kullotave komunale, si dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të pyjeve, kullotave dhe produkteve pyjore dhe jo drusore.



Përgatitja e planeve vjetore të shfrytëzimit konsistoi në këto aktivitete:

1. Kontakt me DSHP-të si aktor kryesor për të koordinuar dhe mbështetur përgatitjen e planeve vjetore operacionale (plan vjetor i shfrytëzimit)
2. Takimi i grupeve kyç në Rajonet e Korçës dhe Kukësit, të cilat iniciuan procesin për të përgatitur një projekt / format draft të përbashkët.
3. U studjua baza ligjore për planin vjetor të shfrytëzimit dhe dokumenti model i miratuar nga MMPAU.
4. U përgatit drafti për përmbajtjen e planeve operacionale simbas propozimeve nga grupet kyç të Korçës dhe Kukësit.
5. Në proces u përfshinë edhe grupet kyç në rajonet të tjera, kryesisht specialistë të Shërbimit Pyjor te Rretheve, stafi i pyjeve në komuna dhe SHPPK; u paraqit korniza e draftit të planit operacional për përmirësimin e mëtejshëm dhe u ra dakord për këtë kornizë.
6. U ngritën kapacitetet e grupeve kyçe për të mbështetur stafin e komunave për përgatitjen e planeve operacionale.
7. U ngritën kapacitetet e stafit të komunave për përgatitjen e planeve operacionale të bazuara në udhëzimet e rena dakord.
8. U përfshi komuniteti në përgatitjen e planeve operacionale të bazuara në udhëzimet e dhëna (nëpërmjet SHPPK-ve por në raste të veçanta edhe përmes takimeve në fshatra).
9. U paraqiten projekt planet operacionale në NjQV për finalizimin dhe miratim e tyre.



## Rezultatet

Bazuar në përpjekjet e projektit, janë arritur rezultatet e mëposhtme:

- Planet vjetore të shfrytëzimit reflektojnë nevojat e fermerëve lokalë dhe praktikat tradicionale.
- 13 komunat pilot përgatishin planet vjetore të shfrytëzimit të bazuara në formatin e përcaktuar.
- 72% e komunave në rajonet pilot në Dibër, Elbasan, Gjirokastrë, Korçë, Kukës dhe Shkodër përgatitën planet vjetore (133 nga 184 komuna). Nëse marrim në konsideratë edhe rajonet e Tiranës, Lezhës dhe Beratit, prej 244 komunave 152 prej tyre kanë përgatitur planet vjetore të shfrytëzimit.
- Të gjitha planet operacionale kanë përfshirë edhe pjesëmarrjen e përdoruesve.
- Janë siguruar fondet për ri-investime në PKK (shih kapitullin për ri-investime)
- U rrit interesi i DSHP-ve për të mbështetur komunat në përgatitjen e planeve vjetore të shfrytëzimit
- U rrit besimi i aktorëve kryesorë që të punojnë së bashku për të adresuar sfidat e pyjeve dhe kullotave komunale
- U përmirësuan njohuritë dhe ekspertizat në përgatitjen e planeve vjetore të shfrytëzimit në komunat pilot.

## Mbledhja e taksave dhe tarifave për ri-investime në PKK

Menaxhimi i duhur i PKK ka nevojë për investime dhe kjo mënyrë kushton. Në vitet e fundit, aktivitetet në PKK, kostot operacionale të SHPPK-ve dhe Federatave Rajonale janë mbuluar nga projekte kombëtare të ndryshme për pyjet. Mbase këto projekte kanë përfunduar, edhe aktivitetet e SHPPK-ve kanë përfunduar gjithashtu. Prandaj mbështetjet financiare janë vendimtare për të siguruar funksionimin e SHPPK-ve dhe zbatimin e planeve të menaxhimit në pyje dhe kullota.



Një mënyrë për të mbledhur fonde për SHPPK-të dhe menaxhimin e PKK është nëpërmjet mbledhjes së taksave dhe tarifave dhe ri-investimi i këtyre fondeve për zhvillimin PKK nga vetë Njësitë e Qeverisjes Vendore. Më parë, këto tarifa janë mbledhur nga Shteti; Leket e grumbulluara kanë qënë të pakta dhe fondet për zhvillimin e aktiviteteve në PKK kanë qene të kufizuara dhe jo konstante, si në rastin e projekteve kombëtare për pyjet. Sipas ligjit të pyjeve dhe rregulloreve, NJQV-të si pronare të ligjshme që administrojnë PKK janë të detyruar për të ri-investuar për menaxhimin e PKK-ve. Disa NJQV-ve mbledhin taksat dhe tarifën. Megjithatë, edhe këto fonde shpesh nuk investohen në zhvillimin e PKK-ve. Prandaj, NJQV-të që kanë marrë në pronësi zonat e PKK, u inkurajuan për të punuar së bashku me SHPPK-të për të mbledhur taksat dhe tarifën nga përdoruesit e PKK dhe të tjerët që përdornin zonat e PKK, dhe për të krijuar fondin e ri-investimit për të financuar zhvillimin e PKK brenda kuadrit rregullator ekzistues. Stafi i projektit ka lehtësuar një sërë takimesh me administratën e komunës, SHPPK-të, dhe komunitetet lokale për të nxitur mbledhjen e taksave dhe tarifave dhe për të krijuar një fond të ri-investimeve. Janë organizuar edhe takime sensibilizuese për të shpjeguar nevojën e mbledhjes së taksave dhe tarifave, për të rritur gatishmërinë e komuniteteve për të paguar këto taksa dhe tarifa për zonat e PKK në përdorim.

Komunat Shllak dhe Shkrel në rajonin e Shkodrës ishin komunat e para në Shqipëri që krijuan një fond të vogël ri-investimesh për pyjet dhe kullotat dhe mblodhen taksat dhe tarifën në bashkëpunim me SHPPK. Edhe pse fondi i ri-investimit është ende i kufizuar në vlerë, ky proces stimuloi interesin e komunave për funksionimin e SHPPK, e cila është plotësisht në përputhje me parimet e decentralizimit. Për më tepër, krijimi i fondeve për ri-investime rriti investimet për zhvillimin e PKK-ve. Ajo gjithashtu rriti transparencën dhe llogaridhënien përmes bashkëpunimit të Komunave dhe SHPPKve.

Në 13 komuna pilote, mbledhja e taksave dhe tarifave është rritur nga viti në vit e cila reflektohet në tabelën 1 më poshtë. Edhe pse asnjë fond ri-investimi ende nuk është krijuar në shumicën e komunave pilote, këto komuna investojnë për zhvillimin e PKK nga buxheti i përgjithshëm i komunës. Në vitin 2012, investimi i përgjithshëm për zhvillimin e PKK ishte më i lartë se sa në vitin 2013. Në vitin 2012, në Komunën Pustec (Liqenas), në rajonin e Korçës janë shpenzuar 1.686.000 lekë për mbjellje, me qëllim të përgjithshëm rehabilitimit. Investimet e bëra kryesisht në zhvillimin e PKK janë bërë në rrallimet, mbrojtjen nga zjarri, pagesat për stafin e pyjeve/rojeve /specialistë të pyjeve, mbjellje dhe/ose gjelbërimin, dhe lerat e ujit për bagëtinë.

**Tabela 1: Të dhënat në mbledhjen e taksave dhe tarifave dhe ri-investimet në 13 Komunat pilot të projektit**

Mesatarja e taksave dhe tarifave të mbledhura për komunë (Lek)			Nr. Total I Komunave me fond ri-investimi			Sasia e investuar në PKK (Lek)		
2011	2012	2013	2011	2012	2013	2011	2012	2013
703,108	807,938	916,062	0	2	2 + 5 në proces	0	6,906,000	5,704,800

Projekti shqyrtoi të ardhurat e NJQV-së që vijnë nga PKK në nivel komune dhe varësinë e fermerëve nga burimet e PKK në mënyrë që të eksplorojë mënyra për të krijuar fondet e ri-investimit në nivel komune në Shqipëri. Komunat ende nuk janë plotësisht të vetëdijshëm për përfitimet e mundshme ekonomike që mund të kenë nga veprimtaritë e ndryshme pyjore dhe investimet. Fermerët akoma nuk janë të vetëdijshëm për përfitimet që ata marrin nga përdorimi i përditësh i pyjeve dhe kullotave të tyre dhe

rëndësinë e pagesës së tarifave për të pasur akses në këto burime. Një studim në nivel fshati u krye për të vlerësuar të ardhurat nga pyjet dhe shfrytëzimi kullotave prej popullsisë lokale (vetëm për familjet, nuk u intervistuan bizneset), duke përfshirë marketingun dhe përdorimin shtëpiak. Projekti zhvilloi këtë anketë për të marrë informacion në sasi dhe shumëllojshmëritë e produkteve pyjore që popullsia lokale merr nga zonat e PKK dhe vlerat e tyre monetare. Rezultatet e anketës u përdoren për të nxjerrë në pah vlerat e zonave të PKK dhe ju komunikuan të gjitha palëve të interesuara, duke përfshirë edhe përdoruesit e PKK me qëllim të përgjithshëm rritjen e vëmendjes dhe gadishmërisë për pagesën e taksës ndaj burimeve që ata përdorin dhe në kthim të tyre kërkesën për shërbime. Në fillim fermerët e hodhen poshtë faktin se ata kanë të ardhura nga pyjet dhe kullotat, por studimi tregoi një realitet tjetër duke dhënë shifra se sa lëndë drusore, lëndë djegëse, fruta, cajra, bimë medicinale, ushqim për kafshët dhe produkte të tjera pyjore fermerët lokale marrin nga PKK. Këto shifra u përkthyen në vlerë monetare bazuar në normat e qeverisë. Në mesatare, të ardhurat nga produktet e pyjeve e kullotave është 260 Euro për familje në vit. Nëse do të përdoren normat e tregut në vend të normave të qeverisë, shifrat e të ardhurave do të jenë edhe më të larta. Shumica e komunave në Shqipëri do të mund të mbledhin taksa & tarifa nga aksesit dhe/ose përdorimi i burimeve të PKK.



SHPPKK-te nga ana tjetër kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur në ndërgjegjësimin e fermereve lokale për nevojën e mbledhjes së taksave dhe tarifave dhe riinvestimeve. SHPPKK-të në komunat Shllak dhe Shkrel u riorganizuan pas zgjedhjeve të organceve drejtuese. Është ndjekur një proces demokratik për zgjedhjen e anëtarëve të bordit të SHPPK-së, i cili siguroi njohjen e SHPPK-së nga NJQV-ja. Përgatitja për riorganizim, përfshiu takime vetë-reflektuese me pjesëmarrje nga nivele të ndryshme të organizatës, nga familje, në fshat, në nivel komune, me fokus të veçantë mbi rolin e grave në aktivitetet pyjore dhe përfshirjen e tyre në strukturat lokale të vendimmarrjes. I njëjti proces është ndjekur dhe u përsërit në komunat tjera pilot të projektit.

Si organ ekzekutiv, roli i Këshillit të Komunës është të miratojë taksat & tarifat dhe të miratojë përdorimin e fondeve për zhvillimin e PKK. Projekti theksoi këtë rol të Këshillit të Komunës dhe siguroi që pylltaria ishte përfshirë në ciklin e planifikimit të Komunës.

Këshilltarët CNVP-së në bashkëpunim me Shërbimin Pyjor, Fakultetin e Pyjeve dhe Federatat Rajonale të Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave Komunale, mbështeten procesin e ngritjes së kapaciteteve për stafin e pyjeve të Komunës për të kuptuar më mirë rolin e tyre në planifikimin e aktiviteteve për zhvillimin e PKK. U organizuan gjithashtu takime konsultative me grupet e fshatrave se si ata mund të bashkëpunojnë



me SHPPK në planifikimin dhe zbatimin e mëvonshëm të punimeve. Mbledhja e taksave dhe tarifave dhe ri-investimi i një pjesë të këtyre fondeve të grumbulluara në zhvillimin e PKK është një instrument i rëndësishëm për realizimin e investimeve bazuar në interesat e fermerëve lokale, transparencës dhe përgjegjshmërisë.



## Rezultatet

Nëpërmjet promovimit të bashkëpunimit shumëpalësh, lobimit dhe veprimtarive ndërgjegjësuere në nivele të ndryshme, projekti ka arritur rezultatet e mëposhtme në lidhje me mbledhjen e taksave dhe tarifave për ri-investim në PKK:

- Rritja e interesit dhe besimit të gjitha palëve të interesuara për të punuar së bashku, duke përfshirë edhe njohjen e SHPPK si partnere të besueshëm dhe të vlefshëm në menaxhimin e qëndrueshëm të PKK.
- Përmirësimi i transparencës dhe rritja e përgjegjshmërisë së komunave për fondet e gjeneruara përmes mbledhjes së taksave dhe tarifave dhe ri-investimit të tyre.
- U krijua Fondi i ri-investimeve në dy komunat Shllak dhe Shkrel me vendim të Këshillit të Komunës për të ri-investuar më shumë se 70% e të ardhurave të tyre nga aktivitetet pyjore në zhvillimit të PKK.
- 5 komuna të tjera pilot janë në proces të krijimit të një fondi të ri-investimeve duke ndjekur shembujt e komunes Shkrel dhe Shllak.
- Pjesëmarrja e komunitetit është rritur pas procesit të riorganizimit të SHPPK-ve përfshirë edhe përfshirjen e grave në vendimmarrje në lidhje me aktivitetet pyjore dhe jo pyjore në nivel fshati dhe komune.
- Përmirësimi i besimit të aktorëve kryesorë që punojnë së bashku për të adresuar sfidat ndaj pyjeve e kullotave komunale
- Përmirësimi i njohurive dhe ekspertizës në përgatitjen e planeve vjetore të shfrytëzimit në komuna pilot.
- Janë bërë investime në zhvillimin e PKK kryesisht në: rrallime, mbrojtjen nga zjarri, pagesat për personelin pyjor / rojtare pylli / specialistë të pyjeve, mbjellje dhe / ose gjelbërim, rehabilitimin e shkurreve në lajthishta dhe lerave me ujë për bagëtinë
- Për disa nga aktivitetet e zhvillimit të pyjeve të përmendura më lart, punëtore nga fshatrat u punësuan nga Komuna të cilët cuan të ardhura në ekonomitë familjare vendore jashtë sezonit bujqësor i cili përbën një periudhë kritike për fshatarët.
- Shumica e komuniteteve të synuara ishin të angazhuar në aktivitetet e PKK e cila rriti vlerësimin dhe optimizmin e tyre për një të ardhme më të mirë të pyjeve dhe kullotave të tyre.

## Pylli i Fermerit

Pylli i Fermerit është një praktikë e menaxhimit të pyjeve të shumë produkteve, të shumë objektivave, të shume llojeve, të shumë-shtresave dhe shumë moshave të fokusuar në nevojat e familjeve vendase. Pyjet, tradicionalisht në përdorim / pronësi të përdoruesve të pyjeve, ishin në gjendje shumë të keqe në fillim të viteve '90 për shkak të mbishfrytëzimit. Që atëherë, janë bërë shumë përpjekje nga përdoruesit lokale tradicionale për të mbrojtur atë që kishte mbetur dhe për të përmirësuar gjendjen e pyjeve. Para fillimit të projektit të II për Forcimin e Pyjeve Komunale, është bërë një punë fillestare për të rritur mirëkuptimin e palëve të interesuara dhe pranimin e përjasjes shumë objektive për menaxhimit të pyjeve si dhe për përfshirjen e këtyre përjasjeve në planet e menaxhimit të PKK dhe planeve vjetore të shfrytëzimit. Gjatë projektit, duke përdorur këtë përjasje, pylli i fermerit u promovua më tej në kombinim me krijimin e sipërfaqeve provë brenda pyllit të fermerit për të fituar njohuri të mëtejshme në prodhimtarinë e llojeve të ndryshme pyjore. Një rrjet i gjerë i sipërfaqeve të përhershme prove u ngrit në bashkëpunim me përdoruesit e pyjeve lokale për të monitoruar kushtet pyjore dhe rezultatet e ndërhyrjeve/trajtimeve në pyje. Sipërfaqet provë gjithashtu përbushen edhe funksionin e demonstrimit. U ngritën në total më shumë se njëqind sipërfaqe prove (48 sipërfaqe provë të reja dhe 59 sipërfaqe prove të krijuara më parë), u matën dhe u monitoruan rregullisht për të dhënë dëshmi dhe informacion mbi modelet e pyllit të fermerëve.



Në përgjithësi, sipërfaqet prove u krijuan për qëllimet e mëposhtme:

1. Krahasimi i sipërfaqeve pyjore të menaxhuara nga i gjithë komuniteti me pyjet që menaxhohen nga përdoruesit tradicionale/pronarë që kanë synim përjasjen me pyllin e fermerit.
2. Demonstrimi i rritjes vjetore të pyjeve dhe dhënien e dëshmimeve tek përdoruesit/pronarët që vlera e pyllit rritet më shpejt se paratë e depozituara në një llogari bankare.
3. Marrja e informacionit për prodhimtarinë e pyjeve dhe në bazë të këtyre rezultateve të rekomandohen hapa të qartë tek politikëbërësit për zhvillimin e pyjeve.



4. Siperfaqet provë do të përdoren nga Federatat Rajonale si sipërfaqe demonstruese për t'ju treguar aktoreve të interesuar mbi menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe përfitimet ekonomike.

Të dhënat që vijnë nga matja e sipërfaqeve provë, për më tepër, janë hedhur në një bazë të dhënash online. Edhe pse, baza e të dhënave ka hyrje të kufizuara në këtë moment, ajo do të përmirësohet më tej dhe aktorët kryesorë do të mund të kenë mundësi mbi këtë informacion dhe madje edhe të gjenerojë raporte për nevojat e tyre.

Në çdo rajon të synuar modelet pyjore të fermerit janë krijuar në bazë të manualit "Pylli i Fermerit", të përgatitur nga projekti i II për Forcimin e Pyjeve Komunale. Janë identifikuar zonat për ndërhyrje në bashkëpunim të ngushtë me SHPPK-të përkatëse dhe Federatat Rajonale. Zonat e përfshira ju përkasin individëve / familjeve por ka edhe zona që janë në përdorim të përbashkët ose në përdorim të fshatit. Në këtë mënyrë mund të maten edhe ndikimet e të drejtës së pronës në pyje. Dallimet midis pyllit të përdorur nga te gjithë dhe pyjeve që ju përkasin familjeve mund të shihen lehtësisht. Pyjet e përdorur nga te gjithë janë të mbishfrytëzuar pasi përdoruesit shpesh nuk kujdesen shumë për mbrojtjen dhe rigjenerimin e ketyre burimeve. Nga ana tjetër, pyjet e përdorur tradicionalisht dhe në pronësi të familjeve, janë të mbrojtura mirë dhe te përdorura në mënyrë të qëndrueshme.

Modele të ndryshme për pyjet e fermerëve janë krijuar në rajone të ndryshme dhe në lloje të ndryshme pyjesh si sipërfaqe demonstruese si për fermerët ashtu dhe për specialistët e pyjeve. Për shembull, disa modele përfshijnë pyllin e gështenjes ose lajthisë për të vlerësuar dhe për të rritur prodhimtarinë e frutit nëpërmjet vjeljes afat shkurtër. Në rajonin e Dibrës, janë krijuar tre modele: një në lajthi, në të cilën janë të përfshirë shumë gra, dhe dy modele në pyjet e dushkut. Modelet e fundit përfshijnë: krasitje, rrallime dhe vendosje të gardheve prej druri për të reduktuar erozionin në këto siperfaqe.



Krijimi i modeleve të pyllit të fermerit dhe sipërfaqeve provë përkatëse janë udhëhequr nga një grup kyç (i përbërë nga specialistë të Shërbimit Pyjor, Federatat Rajonale, teknikët e komunës, specialistët e pyjeve dhe përdorues të pyjeve, dhe kryetarët përkatës të fshatrave). Projekti përgatiti manuale të ndryshme / module për të udhëzuar zbatimin e modeleve të pyllit të fermerit si dhe modele dhe praktika të tjera brenda kuadrit të PKK për të rritur kapacitetet e përdoruesve të PKK. Manualët më të rëndësishme të përdorura në pylli i fermerit ishin:

- Moduli i Pyllit të Fermerit (përdorim shumë-funksional për pyjet komunale)
- Udhëzues për menaxhimin e kullotave komunale
- Modul për zbatimin e planeve të menaxhimit
- Manual mbrojtjen e pyjeve nga zjarri

- Manual për rrallimin e pyjeve komunale
- Manual për përdorimin e GPS



### Rezultatet

- Të dhëna nga 48 sipërfaqe prove të reja të krijuara dhe 59 sipërfaqe prove të ngritura më parë në lloje të ndryshme të pyjeve.
- Baza e të dhënave online është funksionale dhe pranuar nga SHPPK dhe përdoruesit
- Ngritja e kapaciteteve të Federatave Rajonale për të mbledhur të dhëna nga sipërfaqet provë të përhershme.
- Rritja e njohurive të përdoruesve të pyjeve për të monitoruar prodhimtarinë e pyjeve të tyre
- Rritja e njohurive dhe aftësive të përdoruesve të PKK për të rritur produktivitetin e pyjeve të tyre (sipas nevojave të tyre) me anë të praktikave shumë-produktësh, shumë-objektivshe dhe të shumë-moshave në menaxhimi e pyjeve.
- Përdoruesit e PKK kanë fituar njohuri dhe përvojë në ndërhyrjet në pyje të tilla si rrallime, krasitje, mbledhjen e qëndrueshme të produkteve pyjore dhe parandalimin e zjarrit në pyje për të rritur prodhimin e lëndës drusore, druve të zjarrit dhe produkteve pyjore jo drusore.
- Komunitat dhe specialistët e pyjeve pranojnë konceptin e pyllit të fermerit.
- Planet vjetore të shfrytëzimit (shih kapitullin 3) e të gjithë komunave pilot reflektojnë një përjasje të pyllit të fermerit dhe përfshijnë strategjitë e menaxhimit shumë-produktësh.

### Sfidat dhe mundësitë

Përveç të gjithë rezultateve të përshkruara më lart, mbeten një numër i madh sfidash që duhen të adresohen dhe mundësi të ndryshme që duhet të përdoren për të siguruar një konsolidim dhe replikim më të gjërë të arritjeve të projektit. Ky kapitull trajton sfidat kryesore dhe mundësitë në lidhje me: 1) Bashkëpunimin në menaxhimin e pyjeve (shih

edhe kapitullin 2), planifikimi vjetor i shfrytëzimit (kapitulli 3), mbledhja e taksave dhe riinvestimet (kapitulli 4) dhe Pylli i fermerit (kapitulli 5).

### Bashkëpunimi në menaxhimin e PKK

Sfidat	Mundësitë
<ul style="list-style-type: none"> <li>NJQV kanë burime të kufizuara njerëzore për të zbatuar rolet dhe përgjegjësitë e tyre sipas legjislacionit</li> <li>Komunat nuk janë në gjendje të organizojnë vetë procesin e planifikimit dhe menaxhimit të PKK.</li> <li>Bashkëpunimi midis palëve të interesuara duhet të forcohet më tej për të kombinuar pikat e forta dhe të modernizojë përpjekjet në menaxhimin e zonave të PKK.</li> <li>Përmirësimi i legjislacionit dhe rregulloreve për Menaxhimin e Pyjeve Komunale (MPK)</li> <li>Përfshirja nga Qeveria e aktorëve të MPK në përgatitjen e legjislacionit të ri të pyjeve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Federatat rajonale munden dhe duhet të vazhdojnë të ofrojë mbështetje përmes bashkëpunimit, hartimit të planeve teknike në bazë të planeve vjetore të shfrytëzimit, programeve të ndërgjegjësimit dhe të koordinojë aktorët përkatës rajonalë</li> <li>Legjislacioni i ri me role dhe kompetenca të qarta duhet të rrisë bashkëpunimin midis NJQV, SHPPK, DSHP dhe aktorëve të tjerë përkatës për zbatimin e planeve të menaxhimit në pyje dhe kullota</li> <li>Krijimi i një strukture menaxhuese në nivel komune për të marrë rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me zonat e PKK sipas rregulloreve dhe kuadrit ligjor</li> <li>Bashkëpunimi midis SHPPK-ve në vend, Federatave Rajonale dhe Federates Kombëtare për të gjetur mbështetje dhe për të zhvilluar propozime konkrete për rishikimin e legjislacionit</li> </ul>

### Plani Vjetor i Shfrytëzimit

Sfidat	Mundësitë
<ul style="list-style-type: none"> <li>Mungesa e personelit të kualifikuar teknik në NJQV dhe kapaciteteve për të përgatitur planin vjetor operacional</li> <li>Struktura për planin operacional duhet përmirësuar dhe miratuar nga MMPAU</li> <li>Përgatitja e planit operacional para miratimit të buxhetit vjetor në komunë</li> <li>Mungesa e një programi vjetor monitorimi për të siguruar zbatimin e planit vjetor të shfrytëzimit</li> <li>Burimet e tjera natyrore si bimë medicinale dhe aromatike (MAP), arra,</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>DSHP-të (Shërbimi i ekstensionit) mund të mbështesin NJQV-të me këshilla teknike për përgatitjen e planeve operacionale në komunë.</li> <li>Ngritjen e kapaciteteve të stafit të komunës në vazhdimësi për përgatitjen e planit vjetor të shfrytëzimit për të zbatuar Planin e Menaxhimit në PKK.</li> <li>Përmirësimi i planit operacional duke përfshirë edhe burimet e tjera natyrore të pyjeve dhe kullotave (MAP, arra dhe fruta të tjera pyjore etj)</li> </ul>



fruta të tjera pyjore, etj nuk janë vlerësuar dhe shpesh nuk përfshihen në planet operative.	
--	--

### Mbledhja e taksave & tarifave dhe ri-investimet

Sfidat	Mundësitë
<ul style="list-style-type: none"> <li>Komuniteti në zonat e PKK është i varfër i cili krijon probleme në pagimin e taksave dhe tarifave.</li> <li>Komunat kanë fonde të kufizuara në dispozicion dhe shpesh përdorin fondet e mbledhura nga taksat dhe tarifatat në pyje për qëllime të tjera dhe jo për zhvillimin e PKK.</li> <li>Shumica e komunave nuk kanë fonde për ri-investime dhe nuk ri-investojnë në menaxhimin dhe zhvillimin e PKK.</li> <li>Mungesa e marrëveshjeve midis institucioneve për të krijuar dhe zbatuar sistemin e mbledhjes së taksave dhe tarifave për të riinvestuar në PKK.</li> <li>Mungesa e njohurive dhe ndërgjegjesimit midis Njësive të Qeverisjes Vendore në lidhje me vlerën e PKK dhe potencialin e tyre për zhvillimin ekonomik lokal.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Synimi i të interesuarve shumë palësh për të ndërtuar dhe për të promovuar një sistem gjithëpërfshirës për mbledhjen e taksave dhe tarifave dhe ri-investimin në zhvillimin e komunitetit lokal.</li> <li>Mbledhja e taksave nga burimet e tjera pyjore, duke përfshirë shërbimet si linjat e energjisë, shtylla, tubacionet, miniera etj.</li> <li>Gatishmëria e komunave për të krijuar një buxhet për ri-investim dhe për të shpenzuar fondet e gjeneruara përmes mbledhjes së taksave dhe tarifave për zhvillimin e PKK në vitet e ardhshme.</li> <li>Vazhdimi i ndërtimit të kapaciteteve dhe programit për rritjen e ndërgjegjesimit të komuniteteve lokale në lidhje me mbledhjen e taksave dhe tarifave dhe ri-investim në zonën e tyre</li> <li>Takimet konsultative me fermeret për të vendosur taksat dhe tarifatat dhe prioritetet për ri-investime.</li> </ul>

### Pylli i Fermerit

Sfidat	Mundësitë
<ul style="list-style-type: none"> <li>Mungesa e njohurive të fermerëve dhe komunës për të zbatuar metodat / sistemet e pyllit të fermerit.</li> <li>Mungesa e personelit të kualifikuar në NjQV</li> <li>Mungesa e interesit nga DSHP-të për të mbështetur pyllin e fermerit (personeli i kufizuar në DSHP, mungesa e</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Gatishmëria e përdoruesve për të përmirësuar pyjet e tyre.</li> <li>SHPPKK dhe Federatat Rajonale kanë rritur kapacitetet dhe janë të gatshëm për të mbështetur përdoruesit e pyjeve për pyllin e fermerit.</li> <li>Shërbimi i Ekstensionit në Pyje duhet të ofrojë trajnime bazuar në rregulloren e</li> </ul>

<p>infrastrukturës / pajisjeve etj)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>NJQV-të nuk janë të angazhuara plotësisht për menaxhimin e pyjeve.</li> </ul>	<p>Ministrisë së Mjedisit për funksionimin e strukturës së shërbimit pyjor të ekstensionit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Manuali për pyllin e fermerit mund të përdoret për të promovuar pyllin e fermerit dhe të udhëzoje zbatimin në terren.</li> <li>Pylli i fermerit mund të përfshihet në planet operationale.</li> <li>Shumica e pyjeve të fermerëve janë pyje të rinj ku praktikave të menaxhimit për të zhvilluar pyje shumë-produktsh, shumë-objektivsh, shumë-speciesh, shumë-palësh dhe shumë-mosharë mund të aplikohen lehtë.</li> <li>Promovimi i praktikave më të mira të pyjeve shumë-produktsh dhe menaxhimi i kullotave bazuar në mësimet e nxjerra dhe monitorimin e pyjeve të fermerëve.</li> <li>Zhvillimi i mëtejshëm i bazës së të dhënave në internet për të mësuar dhe të ndarë njohuritë në lidhje me pyjet e fermerëve.</li> </ul>
--	--

## Konkluzione dhe Rekomandime

Projekti i II për Fuqizimin e Pyjeve Komunale ka dhënë një kontribut të konsiderueshëm dhe të plotë të praktikave të qëndrueshme të pylltarisë komunale. Projekti ka punuar në përmirësimin e bashkëpunimit, planifikimin vjetor të shfrytëzimit, mbledhjen e taksave e tarifave dhe ri-investimi në pyje e kullota, dhe pyllin e fermerit. Si rezultat, NJQV-të në 13 komnatat pilote janë të vetëdijshme për nevojën e bashkëpunimit me palët e tjera të interesuara, duke përfshirë SHPPK-të, rëndësinë e përgatitjes së vazhdueshme të planit vjetor të shfrytëzimit/punimeve, mbështetjen dhe zbatimin e pyllit të fermerit, dhe planifikimit për mbledhjen e taksave dhe tarifave dhe krijimin e fondeve për ri-investime.

Ngritja e kapaciteteve dhe aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësisë së projektit kanë rritur interesin dhe motivimin e NJQV-ve për të bashkëpunuar me SHPPK-të dhe palët e tjera përkatëse për veprim të përbashkët në menaxhimin e PKK. Komnatat kanë forcuar marrëdhëniet e tyre me përdoruesit lokalë / pronarët për menaxhimin e zonave të PKK. Si rezultat, menaxhimi i PKK-ve është rritur me aktivitete të përbashkëta dhe zbatimin e planeve të menaxhimit është zbatuar bazuar në rolet dhe mandatet e NJQV-ve siç përshkruhet në legjislacionin e rishikuar. Megjithatë, NJQV-të dhe administrata e DSHP-ve ende ka mundësi për të përshtatur ndryshime dhe përgjegjësi të reja që lidhen me

menaxhimin e PKK sipas kornizës ligjore, veçanërisht në lidhje me transferimin e të drejtave të përdoruesve të zonave të PKK-ve tek përdoruesit/pronarët tradicionale dhe menaxhimin me pjesëmarrje të PKK-ve në mënyrë të tillë që të kufizojë burokracinë dhe konfliktet e interesit. Kur të krijohet bashkëpunimi dhe të jete marre nje angazhim konkret, atehere kjo do të ndihmojë për të ofruar një platformë shumë-aktorësh që do të mund të ndihmojë në zhvillimin e mëtejshëm të PKK-ve; gjithashtu këto platforma theksojnë rëndësinë e organizatave lokale në procesin e decentralizimit.

Përgatitja e planeve vjetore të punimeve/shfrytëzimit ka rritur dëshirën e NJQV-ve për të ri-investuar në zhvillimin e PKK-ve. Planet vjetore japin udhëzime për zbatimin e menaxhimit të PKK-ve duke përfshirë sasinë e produkteve pyjore që mund të mblidhen çdo vit në mënyrë të qëndrueshme. Pra, plani ofron njohuri në sasinë e taksave dhe tarifave që mund të mblidhen dhe nevojën për ri-investime në zhvillimin e PKK-ve. Ngritja e kapaciteteve të stafit të komunës në menaxhimin e PKK-ve dhe përgatitja e planeve vjetore duhet të vazhdojnë për të siguruar zbatimin e qëndrueshëm të planit 10 vjeçar të menaxhimit të PKK-ve. Një sistem për mbledhjen e taksave dhe tarifave duhet të përgatitet për çdo NjQV. Megjithatë, zbatimi i planeve vjetore të shfrytëzimit të PKK-ve është një sfidë për shkak të fondeve të kufizuara në dispozicion. Prandaj, planifikimi duhet të jetë në përputhje me fondet që mund të gjenerohen përmes mbledhjes së taksave dhe tarifave. Komunitat duhet të jenë të gatshme që të krijojnë fonde për zhvillimin e PKK-ve çdo vit. Koha më e mirë për përgatitjen e planit vjetor të punimeve/shfrytëzimit është para miratimit të buxhetit vjetor në komunë.

Koncepti i pyllit të fermerit duhet të udhëheqë menaxhimin e PKK-ve, sidomos gjatë përgatitjes së planeve vjetore. Pylli i Farmerit, fillimisht u si një koncept i ri në Shqipëri gjatë Projektit të I-rë për Forcimin e Pyjeve Komunale. Pylli I fermerit është një praktikë e menaxhimit të pyjeve shumë-produktsh, shumë-objektivash, shumë llojesh, shumë-shtresa dhe shumë-mosha, fokusuar në adresimin e nevojave të familjeve lokale. Pylli i fermerit bazohet në zgjedhjet dhe nevojat e vetë fermerëve për produkte pyjore, të tilla si: dru zjarri, hunj, foragjere, fruta, produkte medicinale dhe aromatike, etj. Nëpërmjet pyllit të fermerit, fermerët vendas mund të përcaktojnë strategjitë e tyre më të mira të menaxhimit të pyjeve. Prandaj, e ardhmja e pylltarinë komunale duhet të bazohet në parimet e pyllit të fermerit/familjes.





**Fuqizimi i Qëndrueshëm i Pyjeve Komunale II** është një program tre-vjeçar për forcimin e mëtejshëm të kapacitetit të shoqatave të përdoruesve lokalë të pyjeve dhe kullotave dhe njësive të qeverisjes vendore në veçanti, forcimi i lidhjeve ndërmjet aktorëve dhe grupeve të interesit për menaxhimin e qëndrueshem. të pyjeve dhe kullotave komunale. Ai promovon vendimmarrjen e decentralizuar dhe planifikimin e përmirësuar, në mbështetje të zhvillimit ekonomik lokal më përfshirës. Kjo përfshin të drejta më të sigurta mbi pronën dhe mundësi të përmirësuar për gjenerimin e të ardhurave për njerëzit që jetojnë në zonat rurale, me një focus të veçantë në promovimin e baraziës gjinore.

Projekti po zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, Federatën Kombëtare të Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave Komunale dhe është bashkëfinancuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Hollandës përmes SNV Organizatës Hollandeze për Zhvillim.

**Connecting Natural Values & People**

Zayed Centre Floor 7, Tirana e Re

PO Box 1735

Tirana, Albania,

Tel +355 4 222 9642, +355 4 2229551

ëëë.cnvp-eu.org

Project managed by:



Co-financed by:



Implemented in partnership ëith:

